



Titulli i projektit

Ndërtimi i tregut të produkteve bujqësore dhe blektorale në qytetin e Bajram Currit

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Bajram Curri, të gjitha NJQV-të e Zonës Funksionale do të përfitojnë

Buxheti i paravlerësuar

7,200,000 lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Një nga gjetjet kryesore të studimit mbi Zonën Funksionale Tropojë është se fermerët nuk janë të orientuar nga tregu dhe në përgjithësi, prodhimi bujqësor dhe blektoral përdoret për plotësimin e nevojave individuale të familjeve fermere. Një pjesë e vogël e prodhimeve bujqësore dhe blektorale tregtohen në qytetin e Bajram Currit, ose në funksion të turizmit në Luginën e Valbonës. Orientimi dhe mbështetja për fermerët për të dale në treg, apo për grumbullimin, përpunimin e marketimin e prodhimeve bujqësore dhe blektorale, ka qenë e pamjaftueshme. Bajram Curri nuk ka një vend të përshtatshëm dhe sipas standardeve për tregtimin e produkteve bujqësore dhe blektorale nga fermerët e fshatrave përreth. Mishi, qumështi dhe produktet e tjera bujqësore dhe blektorale shiten drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë primitive nëpër rrugë. Vetëm një pjesë e vogël përpunohet në kushtet e shtëpisë, kryesisht për plotësimin e nevojave familjare dhe më pak për treg. Ka disa vende të përshtatshme për ndërtimin e tregut të produkteve bujqësore dhe blektorale. Një ndër këto vende mund të jetë Kojë, në periferi të qytetit dhe me akses të lehtë për banorët e fshatrave përreth.

Qëllimi/et specifike të projektit

Sigurimi i tregimit të produkteve bujqësore dhe blektorale sipas standardeve.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

1. Furnizimi i tregut me produkte bujqësore dhe blektorale është rritur dhe përmirësuar.
 2. Të ardhurat e familjeve fermere nga dalja në treg me produktet e tyre bujqësore dhe blektorale janë rritur.
 3. Ambjenti në përgjithësi në qytetin e Bajram Currit është përmirësuar.
- Nga ky projekt do të përfitonin të paktën rreth 200 fermerët të zonës funksionale Tropojë, që do të tregtonin produktet e tyre në kushte të përmirësuara dhe do të rrisnin të ardhurat e tyre. Megjithatë tregu do të vendoset në qytetin e Bajram Currit, përfitues do të jenë të gjithë banorët dhe bizneset e zonës funksionale. Rreth 8000 banorë të qytetit Bajram Curri dhe rreth 6000 banorë të fshatrave të komunave përreth (Fierzë, Bujan, Llugaj, Tropojë, Margegaj, Bytyç dhe Lekbibaj) do të përfitonin duke pasur mundësi të blejnë produkte bujqësore dhe blektorale në kushte të përmirësuara.



Aktivitetet e projektit

1. Përgatitja e projektit teknik.
2. Studimi i fizibilitetit dhe vendosja e tarifës për përdoruesit e tregut.
3. Sistemimi i sheshit 3000 metër katrorë (gërmim, sistemim, kanalizim, asfaltim)
4. Vendosja e tryezave të tregtimit që akomodojnë 200 fermerë.

Kohëzgjatja e realizimit të projektit është rreth 6 muaj.

Maturimi i projektit

Projekti është në fazën e projekt-idesë. Nuk ka ndonjë projekt teknik të zhvilluar apo studim fizibiliteti.

Kosto është e përafërt, e vendosur duke u bazuar në eksperiencat e ngjashme në NJQV të tjera.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e financimit mund të jenë fondet publike (nga njësitë e qeverisjes vendore, apo qeverisja qendrore) dhe donatorët potencialë.

Realizimi i punimeve do të bëhet nëpërmjet kontraktimit të kompanive të ndërtimit, fituese e tenderit publik të zhvilluar nga Bashkia.

Kostot e projektit

Kosto totale e përafërt e projektit është 7,200,000 lekë, përfshirë:

1. Përgatitja e projektit teknik (700,000 lekë).
2. Studimi i fizibilitetit dhe vendosja e tarifës për përdoruesit e tregut (përfshirë në 1).
3. Sistemimi i sheshit 3000 metër katrorë (gërmim, sistemim, kanalizim, asfaltim, furnizim me ujë, etj.) (4,500,000 lekë)
4. Vendosja e tryezave të tregtimit që akomodojnë 200 fermerë (2,000,000 lekë).